



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/15

Prishtinë,më 27 shtator 2004, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Fatmir **Sejdiu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 79 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e partive politike;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtaritë kërkimore-shkencore;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tubimet publike
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zeytari;
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit;
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për librin amzë;
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e vulave të IPVK-ve;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për "Gazetën Zyrtare" të Kosovës;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patentime;
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për teatrin;
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës;
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi;
15. Shqyrtimi i vendimit të Panelit të posaçëm lidhur me mocionin e koalicionit "Kthimi" në Ligjin për transportin rrugor;

16. Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për naftën dhe derivatet e saj;
17. Shqyrtimi i propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve dhe të kryetarit të Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe emërimin e kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Në fillim të seancës deputeti Hali **Ahmeti** paraqiti një prjekdeklaratë lidhur me ndërtimin e rrugës magjistrale Ponoshec - Shën -Gjin «Adriatik-Alpe».

Ai e arsyetoi ndërtimin e kësaj rruge në gjatësi prej 157 km, të cilën e kanë mbështetur: deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, z. Azgan Haklaj, ministrant e ministrive përkatëse të të dyja vendeve, përfaqësuesit e pushteteve lokale, si dhe Banka Botrore.

Kanë mbetur edhe 34 kilometra për t'u asfaltuar dhe hapur rruga e re rreth Bregut të Drinit shtoi z. Ahmeti. Është një rrugë komplementare e rëndësishme për Kosovën, Shqipërinë dhe tërë rajonin, duke u lidhur me Portin e Shën-Gjinit dhe në anën tjetër me Malin e Zi, përkatësisht magjistralen e Adriatikut.

Kryetari tha se Kuvendi e mbështetë punën e këtyre deputetëve në realizimin e këtij projekti për ndërtimin e kësaj rruge, por procedurat nuk lejojnë që deklarata e paraqitur të votohet.

Kryetari tha se ka kërkesa për heqjen nga rendi i ditës të kësaj séance pikën e tetë, dymbëdhjetë dhe trembdhjetë, të cilën duhet përkrahur.

Deputeti **Naim Maloku** kërkoi sqarime lidhur me kërkesën për heqjen nga rendi i ditës të pikave të larpëmendura, ngase në komisionet funksionale, gjatë shqyrtimit të projektligjeve, nuk ka pasur kërkesa të tilla dhe janë përgatitur amendamentet lidhur me projektligjet që duhet të shqyrtohen në këtë seancë.

Kryetari tha se kërkesën për heqjen nga rendi i ditës të këtyre pikave e ka parqitur Grupi Parlamentar i LDK-së dhe kërkoi mirëkuptim nga grupet e tjera parlamentare që ta përkrahnin këtë kërkesë.

Deputeti **Lirak Çelaj** tha se në Komisionin Funksional gjatë shqyrtimit të Projektligjit për teatrin, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, pos koalicionit "Kthimi" asnjë anëtar nuk ka qenë kundër miratimit të këtij projektligji. Ai kërkoi që séanca e sotme të vazhdojë punimet, sipas rendit të ditës të propozuar nga Kryesia.

Deputetja **Edi Shukriu** tha se gjatë përgatitjes së amendamenteve lidhur me Projektligjin për teatrin nuk ka paur kurrfarë mosmarrëveshjeje lidhur me këtë. Prandaj, arsyetimi se Lidhja Demokratike dhe ministria përkatëse po kërkojnë të hiqet nga rendi i ditës ky projektligj duhet të dëgjohet këtu.

Bujar Dugoli tha se Grupi Parlamentar i AAK-së është kundër heqjes së këtyre ligjeve nga procedura, sidomos të atyre projektligjeve që ministria – sponsoruesi, dhe Komisioni Funkcional nuk e kërkojnë një gjë të tillë.

Ministri **Behxhet Brajshori** tha se ka paraqitur kërkesën për tërheqjen e projektligjit, ngase gjatë amendamentimit të Projektligjit Ministria nuk ka qenë e ftuar fare t'i harmonizojë qëndrimet me Komisionin.

Me propozimin e këtyre amendamenteve Projektligji substancialisht është varfëruar dhe nuk bën asgjë për të mire, përkundrazi e vështirëson jetën teatrore në Kosovë.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoj të arsyetohen propozimet edhe për tërheqjen e projektligjeve të tjera. Këto projektligje gjatë shqyrtimit të parë i kanë mbështetur të gjitha grupet parlamentare, kurse sponsoruesit e tyre nuk e kanë kërkuar një gjë të tillë.

Në qoftë se ka vërejtje përmbytësore, ato mund të përmirësohen gjatë shqyrtimit të dytë, me miratimin e amendamenteve.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se jemi të bindur se këto tri ligje meritojnë që të jenë më të mira. Ne kemi ardhur në përfundim se amendamentet e ofruara për shqyrtim dhe votim sot bijnë në konflikt me ligjet tjera, bijnë në konflikt dhe kanë mjaft dualizma, prandaj kërkojmë nga seanca plenare dhe nga kryetari i Kuvendit që të japë mundësi të përmirësimit dhe sot mos të shqyrtohen në këtë seancë plenare.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë propozimin për heqjen nga rendi i ditës të pikës së tetë. Rezultati ishte si vijon:

Për-----45;
Kundër-----30.

Kryetari konstatoi: miratohet kërkesa për heqjen nga rendi i ditës ,shqyrtimin e dytë të Projektligjit për përdorimin e vulave.

Kryetari e hodhi në votë heqjen e pikës së dymbdhjetë nga rendi i ditës së seancës së sotme. Rezultati ishte si vijon;

Për-----47.

Kryetari konstatoi: miratohet kërkesa për heqjen nga rendi i ditës, shqyrtimin e dytë të Projektligjit për teatrin.

Kryetari e hodhi në votë heqjen e pikës së trembëdhjetë nga rendi i ditës së seancës së sotme. Rezultati ishte si vijon;

Për-----45.

Kryetari konstatoi: miratohet kërkesa për heqjen nga rendi i ditës, shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Gain Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi të hiqet nga rendi i ditës të seancës së sotme pika e 17-të.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të AA-së, kërkoi të hiqet nga rendi i ditës të seancës së sotme pika e 15-të.

Kryetari tha se këto propozime do të shqyrtohen kur të jenë në radhë për shqyrtim ato pika.

1. Miratimi i proseverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e partive politike në Kosovë.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funkcional lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit të Buxhetit, të Komisionit për Financa dhe Ekonomi dhe të Komisionit për të Drejtat dhe Ineteresat e Komuniteteve.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----75;

Kundër----- 1;

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e **miratoi** Ligjin për financimin e partive politike.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji dhe të deputetit Behxhet Brashori.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22.

Nuk u miratua amendamenti i 9-të.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për veprimtarinë kërkimore - shkencore.

4. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tubimet publike

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Gjuqësi, Legjislacion dhe Kushtetutë të Përkohshme, si dhe të deputetëve Hydajet Hyseni dhe Bujar Dugolli.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 2, 3, 6, 7a, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Nuk u miratuan amendamentet: 1, 4, 5, 7b dhe 10.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për tubimet publike.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zejтари

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit të Buxhetit.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për zejтари.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta

Seancën e kryesoi **Fatmir Sejdiu**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë amendamentet e Komisionit të Kulturës, Rinisë dhe të Sporteve.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 29.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----73;

Kundër----- 1;

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e **miratoi** Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta.

7. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për librat amzë

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----74;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për librat amzë.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Gazetën Zyrtare”

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

E hodhi në votë amendamenti e deputetit Mahir Jagxhilar.

Kuvendi e miratoi amendamentin: 1.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----67;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e **miratoi** Ligjin për “Gazetën Zyrtare”.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë amendamentet e Komisionit të Buxhetit dhe të Komisionit për Financa dhe Ekonomi.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----67;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për administratën tatimore dhe procedurat.

10. Shqyrtimi i dyt i Projektligjit për patentime

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë amendamentet e Komisionit për Tregti dhe Industri.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----68;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për patentime.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë amendamentet e Komisionit të Shëndetësisë.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46 dhe 47.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----68;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për shërbimin privat në shëndetësi.

Kryesuesi njëorë pauzë.

Pas pauzës seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit.

Në mungesë të kuorumit, për ta vazhduar punën e seancës, kryetari i falenderoi të gjithë deputetët e Kuvendit dhe të gjitha grupet parlamentare, për kontributin e dhënë gjatë punës së kësaj legjislature.

Kryetari e deklaroi të përfunduar legjislaturën e parë të Kuvendit të Kosovës.

Séanca i përfundoi punimet në orën 13:45 minuta

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat DACI